



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

**Datë: 14.07.2025
Numër Protokolli: 4740/2025**

A.nr.800/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.800/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi V.M, kundër organit të punësimit: Agjencia e Punësimit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.800/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi, V.M.

A r s y e t i m

Ankuesi V.M (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 05.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit përfundimtar të datës 08.04.2025, lidhur me kandidatin fitues për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00016470, për pozitën Drejtor Ekzekutiv, në Agjencinë e Punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 14.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 02.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.800/2025, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Agjencia e Punësimit, më datë 27.01.2025, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00016470, për pozitën e punës Drejtor Ekzekutiv,

në Agjencinë e Punësimit, klasa e pozitës Drejtues i lartë, me mandat katër vjeçar, i hapur për aplikim nga data 28.01.2025 deri më datë 26.02.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej 22 kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se i njëjti i është nënshtruar fazës së vlerësimit profesional, ku në testin me shkrim ka arrit 32.8 pikë, ndërsa në intervistën me gojë ka arrit 42 pikë, gjithsej pikë të grumbulluar 70.2.

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit, më datë 08.04.2025, ka publikuar Listën përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve për procedurën e kontestuar të pranimi, nga dhe rezulton se si kandidatë fitues janë shpallur: M.A me 86.6 pikë, M.K me 75 pikë dhe V.M me 74.8 pikë.

Pas publikimit të rezultateve përfundimtare të vlerësimit, të datës 08.04.2025 të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar rezultatin përfundimtar për kandidatët fitues, për pozitën Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Punësimit, mbi pretendimin ankimor se përbërja e Komisionit të pranimi nuk ka qenë në pajtim me Ligjin material, pasi që njëra nga anëtarët e Komisionit ka qenë ende në periudhën provuese, tutje shton se edhe pyetjet e parashtruara në intervistë me gojë nuk kanë përkuar me vendin e punës dhe pozitën e shpallur, sipas ankuesit ka dyshime edhe në vlerësimin e testit me shkrim konkretisht në vlerësimin e eses. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj këtë proces rekrutimi në tërësi.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidatja Nj.M-B, si kandidate në procedurën e njëjtë të rekrutimit konkretisht rekrutimit me numër reference RN00016470, më datë 02.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill kundër procedurës me numër reference RN00016470, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.789/2025, të datës 07.07.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00016470, për pozitën “Drejtor Ekzekutiv” në Agjencinë e Punësimit si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.789/2025, të datës 02.05.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimi për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.789/2025, të datës 07.07.2025, rrjedhimisht, ka anuluar në tërësi procedurën e pranimi me numër reference RN00016470, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesi në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*”. Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.800/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.800/2025, të datës 05.05.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.800/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, V.M;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Punësimit; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*